



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 692 Prot.

Tiranë, më datë 01.07.2020

**VENDIM**

**Nr. 177, datë 09.06.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin kërkimor-shkencor në vazhdim «**Forumi Romak-Butrint, 2020**» drejtuar nga Prof. Dr. Luan Përzhita (IA), Prof. Dr. Dhimitër Condi( IA) dhe Prof. Dr. David Hernandez (Universiteti Notre Dame, SHBA), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Pastrime nga vegjetacioni dhe sondazh arkeologjik tek Shatërvani Romak;
  - Pastrime nga vegjetacioni dhe sondazh arkeologjik tek Ndërtesat Veriore të Forumit.
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

